



**AMBASADA E GREQISË
RANË**

**FTESË /SHPREHJE INTERESI
PËR SHITJE AUTOMJETI**

Ambasada e Greqisë në Tiranë fton shoqërinë shqiptare CLASSIC SHPK – Distributor i Mitsubishi për Shqipërinë, e cila dëshiron dhe ushtron aktivitetin e saj në objektin e kësaj shkrese, të paraqesë ofertë për shitjen e një (1) automjeti SSANGYOUNG Rexton ICON për nevojat e saj, me kosto totale deri në shumën 41.900,00 euro (pa TVSH) ku të shënohet çmimi, shërbimet e ofruara dhe afati i dorëzimit.

Kjo ftesë është subjekt i termave dhe kushteve të mëposhtme:

1. OBJEKTI I FTESËS. Objekti i kësaj ftese është furnizimi me (1) makinë SSANGYOUNG Rexton ICON [sistemi i marsheve automatike, 4x4, 2157 etj.] për nevojat e Ambasadës së Greqisë në Tiranë me kosto totale deri në 41.900,00 euro (pa TVSH).

Kritere: Përshtatshmëria e automjetit për nevojat e Ambasadës, çmimi, afati i menjëhershëm i dorëzimit.

2. HARTIMI I OFERTËS. Oferta dërgohet me shkrim në Ambasadën e Greqisë në Tiranë ose në mënyrë elektronike në adresën e emailit të Ambasadës së Greqisë në Tiranë gremb.tir@mfa.gr në greqisht ose shqip ose anglisht.

3. DOKUMENTET PËR PJESËMARRJE. Shoqëria pjesëmarrëse është e detyruar, nëse ftohet për të kryer furnizimin, të paraqesë: informacion për mos detyrime për sigurimet shoqërore dhe tatimore, Dëshmi të Penalitetit dhe një Certifikatë përfaqësimi të shoqërisë.

4. OFERTA FINANCIARE. Oferta financiare do të përfshijë shumën në euro (me dhe pa TVSH). Në rast se çmimi i ofruar pa TVSH tejkalon buxhetin, oferta e pjesëmarrësit do të refuzohet.

5. PROCEDURA E VLERËSIMIT. Oferta do të vlerësohet për plotësinë e saj dhe do të zgjidhet në përputhje me rrethanat përkatëse.

6. PAGESA. PAGESA e kontraktorit do të bëhet me transfertë bankare nga Ambasada e Greqisë në Tiranë menjëherë pas dorëzimit/provës së drejtimit të automjetit dhe lëshimit të dokumentit ligjor përkatës.

7. BUXHETI. Shuma monetare e buxhetit është dyzet e një mijë e nëntëqind euro (41.900,00€), pa TVSH.

8. DORËZIMI I OFERTËS. Shoqëria e interesuar mund të paraqesë ofertën e saj me shkrim ose ta dërgojë në adresën e emailit gremb.tir@mfa.gr sa më shpejt të jetë e mundur, deri më datë 01.12.2023 e Premte, ora 12:00 në Ambasadën e Greqisë në Tiranë.

Oferta është e detyrueshme për periudhën deri në dhënien dhe përfundimin e furnizimit.

9. KOHA E DORËZIMIT. Dorëzimi i automjetit duhet të kryhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune nga njoftimi me shkrim/elektronik i kontraktorit nga Ambasada e Greqisë në Tiranë.

Kjo Ftesë për Shprehje Interesi do të publikohet në portalin e Regjistrimit Qendror Elektronik të Kontratave Publike dhe në faqen e internetit të Ambasadës së Greqisë në Tiranë në adresën <https://www.mfa.gr/albania/presveia/>.

Informacion mbi ecurinë e procesit të prokurimit mund të merrni në numrat e kontaktit të Ambasadës së Greqisë në Tiranë.

Tiranë, 29/11/2023



AMBASADORJA
Konstantina KAMITSI

I AUTORIZUAR